

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

**PËR MIRATIMIN E NORMAVE, STANDARDEVE, ÇMIMET BAZË
DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA NË FUSHËN E PYJEVE**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i normave, standardeve, çmimeve dhe kategorive për njësi të punimeve sipas operacioneve që kryhen në pyje dhe kullota, me synim:

- përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- rritje të efikasitetit të punës;
- mbrojtje të mjedisit dhe biodiversitetit;
- harmonizim me praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Aspekti më i rëndësishëm për trajtimin e fondit pyjor e kullotave janë punimet e ndryshme që duhet të kryhen, bazuar në praktikat më të mira, të rekomanduara apo përcaktuara nga planet e mbarështimit, që lidhen me përmirësimin e gjëndjes së këtyre burimeve, nëpërmjet ngritjes së fidanishteve dhe punimeve në to, pyllëzimeve, prerjeve kulturale, mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit, ndërtimin e pritave malore për mbrojtjen e tokës nga erozioni, ndërtimin dhe riparimin e lerave, hauzeve dhe korritave për ujin e pijshëm të blegtorisë, etj.

Në këtë kuadër, është vlerësuar në aspektin teknik që realizimi i operacioneve, standardeve dhe çmimeve bazë të punës, sipas nivelit dhe vështirësive me koeficientët e indeksimit tyre që do realizohen nëpërmjet fondeve buxhetore apo nëpërmjet donacioneve të ndryshme, të kryhet në mënyrë të unifikuar në të gjithë territorin e RSH nga çdo person juridik ose fizik, vendas ose i huaj.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Mjedisit për vitin 2025. Gjithashtu projektvendimi është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e pyjeve. Miratimi i këtij projektvendimi kontribuon gjithashtu në zbatimin e masave të parashikuara në Dokumentin e Politikave për Pyjet në Shqipëri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon miratimin e normave, standardeve teknike, çmimeve dhe kategorive për njësi të punimeve sipas operacioneve që kryhen në pyje dhe kullota, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës, mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit dhe harmonizimin e praktikave me standardet kombëtare dhe përafrimin e tyre me praktikat ndërkombëtare.

Duke qenë se ky akt ka karakter teknik që lidhet me përcaktimin e normave, standardeve dhe kategorive për njësi të punimeve sipas operacioneve që kryhen në pyje e kullota, të përcaktuara në lidhjet nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, ato do të përdoret në administratën publike, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, subjekte private vendase apo të huaja, institucione si dhe aktorë të ndryshëm.

Projektvendimi është ndarë në (3 tre) lidhje (pjesë), ku Lidhja nr.1, përfshin normat, standardet, kategoritë përkatëse sipas operacioneve të punës në pyje e kullota, duke përfshirë edhe inventarizimin dhe mbarështimin e pyjeve e kullotave. Lidhja nr.2, përfshin normat, standardet dhe kategoritë e punës në shfrytëzimin e pyjeve, si dhe Lidhja nr.3, përfshin koeficientët e indeksimit të pagave (kundrejt kategorisë së pare), për kategoritë e dytë, tretë dhe katërt.

Projektvendimi do të kontribuojë në përshtatjen vendosjen e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira për realizimin e të gjitha punimeve që kryhen në pyje e kullota, rregullimin e standardeve, kategorive dhe normave në shfrytëzimin e pyjeve, si shërbime të domosdoshme, për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të pyjeve, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore në to duke zëvendësuar normat e standardet në fuqi, të përcaktuara sipas manualit të miratuar me Urdhërin nr.3, datë 19.8.1985 të Ministrit të Bujqësisë.

Efektet e pritshme të këtij projektvendimi janë:

1. Nëpërmjet miratimit të normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira për realizimin e të gjitha punimeve që kryhen në pyje e kullota, rregullimin e statandarëve, kategorive dhe normave në shfrytëzimin e pyjeve, do të sjellë një përmirësim të zbatimit të parashtrimeve ligjore e teknike të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.;
2. Nisur nga zhvillimi i qëndrueshëm në sektorin e pyjeve, rregullimet teknike dhe ligjore lidhur me trajtimin dhe shfrytëzimin e pyjeve për material drusor dhe prodhimeve pyjore jodrusore, bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET), , do të ndikojnë në rregullimin e marrëdhënieve në këtë sektor, si dhe do të sjellë ndikim pozitiv në cilësinë e mjedisit natyror;
3. Krijimi i një dokumentacioni teknik dhe referues për të gjitha operacionet e punës në pyje e kullota, duke patur parasysh ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike, regjimit hidrik, etj.;
4. Krijimi i referencave dhe lehtësirave për strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat në bashki, duke u mundësuar atyre pikat orientuese për punimet e ndryshme në pyje e kullota, duke sjellë mirë administrimin, rehabilitimin, rigjenerimin dhe shtimin e vlerave të tyre;
5. Rregullimi i procesit të administrimit të punimeve në pyje e kullota dhe shfrytëzimit të pyjeve, në mënyra dhe intensitete të tilla që të ruajnë larminë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjera.
6. Standardizimi, normimi i punës, standardet, çmimet bazë e praktikat e mira të hartimit të projekteve për punimet në pyjet e kullotat, do të jenë një ndihmë shumë e madhe në punën e strukturave përgjegjëse për pyjet në shërbimit pyjor, qeverisjeve vendore, shoqatave të përdorimit të pyjeve e kullotave komunalë, organizatave të ndryshme jofitim prurëse, subjekteve privatë dhe të gjithë të interesuarëve të tjerë, për planifikimin e buxheteve të nevojëshme, për punimet që do të kryhen në kuadrin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore si dhe për monitorimin e kontrollin e tyre. Gjithashtu ato do të ndihmojnë edhe për zhvillimin korrekt të veprimtarive fitimprurëse.

Së fundmi, sqarojmë se për hartimin e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira për realizimin e të gjitha punimeve që kryhen në pyje e kullota, jemi mbështetur në njësitë matëse, normat për punëtor, standardet teknike (lloji i punë, cilësia, mjetet e përdorura, koha e lejuar) dhe kategoritë e punës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor kombëtar të sektorit të pyjeve dhe hartohet në zbatim të nenit 15, pikat 2, shkronja “c”, të Ligjit 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në pikën 1, përcaktohet miratimi i normave, standarteve dhe kategorive për njësi të punimeve sipas operacioneve që kryhen në pyje e kullota, të përcaktuara në lidhjet nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë e tij.

Normat e punimeve në pyje e kullota janë ndarë në 2 (dy) grupe, minimale dhe maksimale. Arsyeja e vetme për ndarjen është se punimet kryhen në sipërfaqe dhe vende që në pjesën më të madhe ndodhen në distanca të largëta nga vendbanimet e punëtorëve, pavarësisht se mund të ketë banorë të fshatrave në afërsi të pyjeve e kullotave. Normat minimale përdoren në rastet kur objektet e punimeve ndodhen në largësi mbi një orë e gjysmë, ecje në këmbë (vajtje) nga vendbanimi i punëtorit dhe në largësi mbi gjysmë ore udhëtim me automjetet e mbi 1 orë ecje në këmbë (vajtje), nga vendbanimi i punëtorit, ndërsa norma maksimale për rastet e objekteve nën këto distanca kohore.

Duke qenë se normat e standardet e punës janë të para 40 viteve, doli e nevojshme dhe rishikimi të këtyre normave dhe përshtatjen e tyre me kushtet konkrete të tregut. Gjatë rishikimit u analizuan aspektet dhe faktorët mbi të cilat ato ishin ndërtuar, krahasuar me ato të kësaj periudhe. Njëherësh u morrën në konsideratë edhe eksperiencia e sektorit privat në vendin tonë dhe ajo e disa vendeve të tjera. Për këtë u parashikua edhe autorizimi ligjor sipas nenit 15, pika 2, shkronja “c”, e ligjit 57/2020 ‘Për pyjet’.

Standardet janë sipas operacioneve të punimeve të ndyshme që kryhen në pyje e kullota, punime që janë specifike që me ndërtimin, organizimin dhe mbajten e fidanishteve, punimet në pyllëzime, sistemimet (pritat) malore, prerjet kulturore, shfrytëzimet, si dhe invanatarizimin dhe mbarështimin e pyjeve dhe kullotave.

Në pikën 2, përcaktohen çmimet bazë janë vlerat e llogaritura për njësi të punimeve sipas operacioneve dhe shërbejnë si referencë për:

- a) hartimin e preventivave të projekteve të studimit dhe zbatimit;
- b) planifikimin e buxhetit vjetor të investimeve dhe shërbimeve nga administrata publike qendrore dhe vendore;
- c) llogaritjen e çmimeve dhe kostove nga subjektet sipërmarrëse që ushtrojnë veprimtari në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Në pikën 3, kategorizohen punimet në pyje e kullota, të cilat ndahen në 4 (katër) kategori pune, sipas nivelit të vështirësisë dhe natyrës së operacioneve, me koeficientët përkatës të indeksimit kundrejt pagës së kategorisë së parë. Paga e kategorisë së parë i referohet pagës minimale mujore të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe është e detyrueshme për t’u zbatuar në të gjithë territorin nga çdo person juridik ose fizik, vendas ose i huaj. Koeficientët dhe kategorizimi përcaktohen në Lidhjen nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në pikën 4 parashikohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi dhe në pikën 5 parashikohet hyrja në fuqi e këtij vendimi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është propozuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për pyjet dhe me Drejtorinë juridike në Ministrinë e Mjedisit.

Projektvendimi do të përcillet për mendim pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Sofjan JAUPAJ

